



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 850/6 prot.

Datë 08.04.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 478/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.04.2026, shqyrtoi kërkesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “inAuto” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me objekt “Blerje Automjete” me Nr. REF-73293-12-24-2025, me fond limit: 8,300,000 (tetë milion e treqind mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.01.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Selenicë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Anadea” SHPK në procedurën e prokurimit të mësipërme.

Lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “inAuto” SHPK në procedurën e prokurimit të mësipërme

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “in Auto” SHPK me NIPT M31417021V me adresa: Rruga “Gjoke Doci”, Numri i pasurise 630/449, Tiranë.

Operatori ekonomik “Anadea” SHPK me NUIS L87201401H dhe adresë: Njësia Administrative Shupenzë, Bashka Bulqizë, Lagjja Qendër, Rruga Nacionale Peshkopi – Tiranë, Bulqizë.

- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Selenicë  
Rruga “Llambi Bombaj”, Selenicë
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “inAuto” SHPK me NUIS M31417021V dhe adresë: Njesia Administrative Nr. 11, Rruga “Gjoke Doci”, Numri i pasurise 630/449, Zona Kadastrale, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimes “inAuto” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Operatori ekonomik ankimes “Anadea” SHPK nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 26-12-2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me objekt “Blerje Automjete” me Nr. REF-73293-12-24-2025, me fond limit: 8,300,000 (tetë milion e treqind mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.01.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Selenicë.

II.2. Në datën 09-01-2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 16.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Anadea” SHPK	7,500,000 lekë	kualifikuar
2. “inAuto” SHPK	8,300,000 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 27.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik Njoftimin e Fituesit Paraprak të procedurës së prokurimit.

II.5. Në datën 28.01.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 265/2026 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6289 e operatorit ekonomik “inAuto” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-73293-12-24-2025, me objekt: “BLERJE AUTOMJETE”, me fond limit 8,300,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.

Nga shqyrtimi i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Anadea” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit 265/1 prot., datë 29.01.2026.

II.7. Në datë 05.02.2026, operatori ekonomik “Anadea” SHPK ka dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave elektronike “Formular i paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën me nr. 265/2 prot., datë 05.02.2026.

II.8. Me shkresën me nr. 261/6 prot., datë 06.02.2026, me lëndë “Informacion”, dorëzuar nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 265/3 prot., datë 12.02.2026, autoriteti kontraktor Bashkia Selenicë ka dorëzuar aktin e shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “inAuto” SHPK, vendim nr. 1, datë 04.02.2026 nga ku rezulton se ka vendosur pranimin e plotë të ankesës.

II.9. Me vendimin nr. 287/2026, datë 20.02.2026 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

1. *Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “inAuto” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-73293-12-24-2025, me objekt: “BLERJE AUTOMJETE”, me fond limit 8,300,000.00 (tetë milion e treqind mijë) Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.*
2. *Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.*
3. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “nAuto” SHPK.*
4. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
5. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.10. Në datën 11.03.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Anadea” SHPK	7,500,000 lekë	skualifikuar
2. “inAuto” SHPK	8,300,000 lekë	skualifikuar

II.11. Në datë 12.03.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Njoftimin e anulimit për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.12. Në datë 14.03.2026 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është depozituar ankesa elektronike me numër A/2026/6431 dhe me nr. 850/2026 Prot., date 17.03.2026 e operatorit ekonomik “In Auto” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me objekt “Blerje Automjete” me Nr. REF-73293-12-24-2025, me fond limit: 8,300,000 (tetë milion e treqind mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.01.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Selenicë. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e

vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “In Auto” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.12.1. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit 850/1 prot., datë 17.03.2026.

II.12.2. Me shkresën me nr. 850/2 prot., datë 01.04.2026 me lëndë “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “inAuto” shpk*”, drejtuar autoritetit kontraktor Bashkisë Selenicë, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.12.3. Me shkresën me nr. 261/16 prot., datë 30.03.2026 me lëndë “*Informacion*”, protokolluar me tonën me nr. 850/3 prot., datë 02.04.2026 autoriteti kontraktor Bashkia Selenicë ka dorëzuar aktin e shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “inAuto” shpk, Vendim nr. 2, datë 27.03.2026 “*Për “Shqyrtimin e ankesës me nr. 261/10, datë 18.03.2026 me objekt: Blerje automjete*”, nga ku rezulton se e ka refuzuar ankesën.

II.13. Në datën 17.03.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik, me nr. A/2026/6438, protokolluar me nr. 865/2026 prot, datë 18.03.2026, i operatorit ekonomik “Anadea” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-73293-12-24-2025, me objekt: “Blerje automjete”, me fond limit 8,300,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Anadea” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe ngrihen pretendime për shoqërinë “inAuto” SHPK.

II.13.1. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit 865/1 prot., datë 18.03.2026.

II.13.2. Me shkresën me nr. 865/2 prot., datë 01.04.2026 me lëndë “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Anadea” shpk*”, drejtuar autoritetit kontraktor Bashkisë Selenicë, Komisioni i Prokurimit Publik i ka

kërkuar autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.13.3. Me shkresën me nr. 261/14 prot., datë 27.03.2026 me lëndë “Informacion”, protokolluar me tonën me nr. 865/3 prot., datë 02.04.2026 autoriteti kontraktor ka dorëzuar aktin e shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Anadea” shpk, Vendim nr. 3, datë 27.03.2026 “Për “shqyrtimin e ankesës me nr. 261/11, datë 18.03.2026 me objekt: Blerje automjete”, nga ku rezulton se e ka refuzuar ankesën.

II.14. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk janë paraqitur argumente nga subjektet e interesuara në përputhje me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Anadea” SHPK mbi skualifikimin e padrejtë të ofertës së tij ekonomike dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik “inAuto” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Në datën 26-12-2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me objekt “Blerje Automjete” me Nr. REF-73293-12-24-2025, me fond limit: 8,300,000 (tetë milion e treqind mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.01.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Selenicë.

III.1.2. Në datën 09-01-2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.3. Në datën 16.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

“Anadea” SHPK	7,500,000 lekë	kualifikuar
“inAuto” SHPK	8,300,000 lekë	kualifikuar

III.1.4. Në datën 27.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik Njoftimin e Fituesit Paraprak të procedurës së prokurimit.

III.1.5. Në datën 28.01.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 265/2026 protokoll dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6289 e operatorit ekonomik “inAuto” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-73293-12-24-2025, me objekt: “BLERJE AUTOMJETE”, me fond limit 8,300,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.

**Nga shqyrtimi i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Anadea” SHPK.**

III.1.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit 265/1 prot., datë 29.01.2026.

III.1.7. Në datë 05.02.2026, operatori ekonomik “Anadea” SHPK ka dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave elektronike “Formular i paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën me nr. 265/2 prot., datë 05.02.2026.

III.1.8. Me shkresën me nr. 261/6 prot., datë 06.02.2026, me lëndë “Informacion”, dorëzuar nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 265/3 prot., datë 12.02.2026, autoriteti kontraktor Bashkia Selenicë ka dorëzuar aktin e shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “inAuto” SHPK, vendim nr. 1, datë 04.02.2026 nga ku rezulton se ka vendosur pranimin e plotë të ankesës.

III.1.9. Me vendimin nr. 287/2026, datë 20.02.2026 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “inAuto” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-73293-12-24-2025, me objekt: “BLERJE AUTOMJETE”, me fond limit 8,300,000.00 (tetë milion e treqind mijë) Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.
  2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
  3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “nAuto” SHPK.
  4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.10. Në datën 11.03.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

“Anadea” SHPK	7,500,000 lekë	skualifikuar
“inAuto” SHPK	8,300,000 lekë	skualifikuar

III.1.11. Në datë 12.03.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Njoftimin e anulimit për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.12. Në datën 17.03.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik, me nr. A/2026/6438, protokolluar me nr.865/2026 prot, datë 18.03.2026, i operatorit ekonomik “Anadea” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-73293-12-24-2026, me objekt: “Blerje automjete”, me fond limit 8,300,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Anadea” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe ngrihen pretendime për shoqërinë “inAuto” SHPK.

III.1.13. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit 865/1 prot., datë 18.03.2026.

III.1.14 Neni 110, pika 1 dhe 2, i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: *“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë. 2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*

Neni 111 i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik. 2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës*

së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. 3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur. 4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik”.

Neni 113 “Të drejtat e operatorëve ekonomikë” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë. Paraqitja e argumenteve bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike. 2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi”.

Neni 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre. 2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit. 3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë: a) pranimin e plotë të ankesës; b) pranimin e pjesshëm të ankesës; c) refuzimin e ankesës. 4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës. 5. **Kundër vendimit të autoritetit ose entit**

**kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4 të këtij neni. 6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.**

Neni 115, pikat 1 dhe 2 “Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë: a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin: i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar; ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji; b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji; c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës. 2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankësive për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër”.

Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit. 2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji; b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore; ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji; d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një

*vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankesë tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.*

III.1.15. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Anadea” SHPK mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, si dhe mbi shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik “inAuto” shpk, para shqyrtimit në themel të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, Komisioni referuar kronologjisë së fakteve të parashtruara më sipër, si dhe referuar bazës ligjore të sipërcituar gjen me vend të sqarojë dy momente tepër të rëndësishme, si mbi interesin e ligjshëm të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në kuptim të ligjit aktual në fuqi, ashtu edhe të së drejtës së tyre për të ushtruar të drejtën e ankimit për skualifikimin e ofertës së tyre nga veprimet e autoritetit kontraktor dhe për kualifikimin e operatorëve të tjerë ekonomikë në procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

Bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 110 dhe 113 “Të drejtat e operatorëve ekonomik të interesuar”, parashikohet se: “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë. 2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”. Në nenin 113 parashikohet se: “1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë. Paraqitja e argumenteve bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike. 2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.”, çdo person që pretendon se ka interes në një procedure prokurimi, se është dëmtuar ose që rrezikon të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor duhet t’i referohet një situatë konkrete për të provuar cenimin ose shkeljen e një të drejte ose interesi të ligjshëm, interes i cili individualizohet nga elemente konkrete si subjektet (palët) dhe shkak (e drejta ose marrëdhënia juridike e cenuar që ndodhet në themel të ankesës). Operatori ekonomik ankimues, që rrezikon të cenohet, duhet të identifikojë faktin që përbën cenimin e të drejtës ose interesit të ligjshëm, si dhe të drejtën që synon të realizojë, e cila duhet të jetë konkrete dhe të ketë lindur para dorëzimit të ankesës.

Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, KPP konstaton, se fillimisht në datën 16.01.2026 autoriteti kontraktor ka vlerësuar ofertat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe më pas në datën 27.01.2026 ka publikuar njoftimin e fituesit për

procedurën objekt ankimi. Në datën 28.01.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 265/2026 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6289 e operatorit ekonomik “inAuto” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-73293-12-24-2025, me objekt: “BLERJE AUTOMJETE”, me fond limit 8,300,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë. Nga shqyrtimi i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Anadea” SHPK. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit 265/1 prot., datë 29.01.2026. Në datë 05.02.2026, operatori ekonomik “Anadea” SHPK ka dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave elektronike “Formular i paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën me nr. 265/2 prot., datë 05.02.2026.

Referuar nenit 113 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku subjektet që mund të cenohen nga ankesa e paraqitur kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me ankesat e operatorëve të tjerë, duke përmbushur 3 kushte kumulative: 1. Të cenohen nga ankesa e paraqitur (në rastin konkret është ankesa e operatorit ekonomik “inAuto” SHPK) 2. Kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit (ankesën) njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik 3. Argumentet të paraqiten në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në nenin 113 të ligjit për prokurimin publik.

Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi. Pra, sistemi i ankimit njeh të drejtën e ankimit një herë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoriteteve kontraktore, në rast se operatorët ekonomikë gjykojnë, se për shkak të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mund të cenohen të drejtat e tyre. Ndërkohë, ligjvënësi ka parashikuar edhe të drejtat e subjektit të interesuar në procedurën e prokurimit në përputhje me nenin 113 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në nenin 114 të LPP-së, parashikohet shprehimisht, se “Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës”. Kundër vendimit të autoritetit ose entit

kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, për procedurat nën kufirin e lartë monetar kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni. Ndërsa në nenin 100 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pika 4 dhe 5, parashikohet: “4. *Autoriteti/enti kontraktor merr vendim, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 114, të LPP-së, dhe vë në dijeni, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.* 5. *Kundër vendimit të autoritetit/entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4, të këtij neni”.*

Referuar materialeve të fashikullit administrativ, procedura objekt ankimi është procedurë nën kufirin e lartë monetar, subjekti “Anadea” SHPK si subjekt që çënohej nga ankesa e operatorit ekonomik “inAuto” SHPK me nr. 265/2026 prot., datë 28.01.2026, referuar bazës ligjore të sipërcituar ka të drejtë të paraqes argumentet e tij në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, në këto kushte referuar kronologjisë së fakteve, Komisioni konstaton se argumentet e paraqitura nga operatori ekonomik “Anadea” SHPK në datë 05.02.2026 rezultojnë jashtë afatit kohor të parashikuar nga neni 113 i ligjit “Për prokurimit publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimitarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu, KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor. Sa më sipër, e drejta procedurale e njohur nga ligji për të paraqitur argumente kundër ankesës së operatorëve ekonomikë nga operatorët e tjerë ekonomikë të interesuar, lidhet ngushtësisht me paraqitjen e argumenteve mbi ankesën e dorëzuar nga këto të fundit në kuadër të rishikimit administrativ. Pra, subjektet e interesuara, në paraqitjen e argumenteve duhet të mbajnë në konsideratë, se e drejta procedurale e paraqitjes së argumenteve është e ndryshme nga e drejta e ankimit, pasi kemi të bëjmë me dy momente të ndryshme. E para, (argumenti) lidhet me faktin e kundështrimit të ankesës (paraqitjes së pretendimeve nga palët, se përse ankesa e paraqitur nuk duhet pranuar nga ana e autoritetit kontraktor/Komisionit të Prokurimit Publik), ndërkohë ankesa në thelb përbën një mjet juridik të kundërshtimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor për kualifikimin/skualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë. Pra argumentet në thelb

janë të kufizuara mbi ankesën e operatorit ekonomik. Referuar materialeve të ndodhura në fashikullin administrativ me paraqitjen e ankesës në datën 28.01.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike me nr. 265/2026 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6289 e operatorit ekonomik “inAuto” SHPK duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “Anadea” SHPK, nga ky moment interesat e operatorit ekonomik “Anadea” SHPK mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, dhe nga ky moment i lind e drejta dhe detyrimi për dorëzimin e argumentave në përputhje me afatet ligjore të parashikuar në nenin 113 të LPP-së. Në rastin konkret duke qënë se procedura e prokurimit është procedurë e hapur e thjeshtuar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve nga operatori ekonomik i interesuar është 5 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Referuar materialeve të fashikullit administrativ, rezulton, se në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit 265/1 prot., datë 29.01.2026, rrjedhimisht afati i fundit për dorëzimin e argumentave nga operatori ekonomik “Anadea” SHPK ishte data 03.02.2026, argumentat e dorëzuar nga ky i fundit në datë 05.02.2026 do të konsiderohen të dorëzuar jashtë afatit ligjor të parashikuar nga neni 113 i LPP-së. Rrjedhimisht, referuar nenit 113 i cili parashikon se nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurim ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik “Anadea” SHPK nuk do të merret në shqyrtim nga Komisioni pasi argumentat janë dorëzuar jashtë afatit të parashikuar, duke mos përmbushur në këtë mënyrë kushtet formale për paraqitjen e argumentave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Akoma më tej edhe në hipotezën që argumentet e paraqitura nga operatori ekonomik i interesuar “Anadea” SHPK do të ishin paraqitur brenda afatit kohor të parashikuar nga ligji për prokurimin publik, referuar pikës 5 të nenit 114 të LPP-së, kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, rrjedhimisht ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik “Anadea” SHPK me nr. 865/2026 prot., datë 17.03.2026 sërisht nuk do të përmbushte detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit duke u paraqitur jashtë afateve ligjore.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “inAuto” SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike me arsyetimin se: “[...] Në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik AK ka vendosur si kriter kualifikimi: 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose kontratë bashkëpunimi me Servis të specializuar dhe të licensuar sipas

rregulloreve te Republikes se Shqiperise, për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruar, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale, akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB, etj dhe licensën përkatëse.) Në argumentimin e këtij kriteri, AK është shprehur që: Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162., datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5 të VKM nr. 285., datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Kjo kërkesë lidhet me detyrimin e kontraktorit që gjatë gjithë shtrirjes të garancisë së mjetit të jetë në gjendje të sigurojë suportin teknik dhe pjesët e ndërrimit sipas standartit teknik të përcaktuar nga prodhuesi. Me datë 30.12.2025, subjekti “inAuto”, në zbatim të Nenit 75 Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit , të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ka paraqitur në SPE kërkesën lidhur me këtë kriter, duke vlerësuar se paraqitja e kontratës noteriale me subjektin e servisit realizohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit fizik nga subjekti, pasi kjo është e lidhur drejtpërdrejt me datën e fillimit të garancisë për mjetet. Në kundërshtim me përcaktimet e nenit 75 të LPP, AK nuk ka kthyer përgjigje lidhur me këtë kërkesë. Pas hapjes, shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, me datë 16.01.2026 jemi njoftuar se oferta e subjektit “inAuto” shpk është kualifikuar. Ndërkohë, pas vendimit të KSHA për pranimin e ankesës sonë, dhe vendimit të KPP nr.287/2026 AK ka rishqyrtuar dhe rivlerësuar ofertat, përfshirë këtu edhe ofertën e subjektit “inAuto”. Skualifikimi i ofertës së subjektit “inAuto” shpk është në kundërshtim me rregullat dhe parimet e prokurimit publik, trajtuar si vijon: Së pari, kriteri i vecantë i kualifikimit 2.3.3, për të cilin AK pretendon se nuk përmbushet nga subjekti “inAuto” është i paqartë dhe nuk e mirëpërcakton fazën se kur duhet të përcillet dokumentacioni fizik provues. Në vendosjen e këtij kriteri AK kërkon që Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose kontratë bashkëpunimi me Servis të specializuar dhe të licensuar, por pa specifikuar nëse ky dokumentacion provues për të cilën ofertuesi ka dëshmuar se plotëson, duhet të paraqitet në fazën e ofertimit apo në rast se kualifikohet si fitues dhe para nisjes së afteve të ankimit. Në kriteret e tjera të kualifikimit AK e ka përcaktuar qartë momentin e dorëzimit të dokumentacionit provues, në të cilët përdor shprehjet si: duhet të paraqesë e cila nënkupton dorëzimin e dokumentacionit në fazën e ofertimit, ose Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1 Në shtojcën 8 të dokumentave të tenderit “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.3 autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

**2.3.3 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose kontratë bashkëpunimi me Servis të specializuar dhe të licensuar sipas rregulloreve te Republikes se Shqiperise, për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruar, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale, akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB, etj dhe licensën përkatëse.)**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162., datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5 të VKM nr. 285., datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Kjo kërkesë lidhet me detyrimin e kontraktorit që gjatë gjithë shtrirjes të garancisë së mjetit të jetë në gjendje të sigurojë suportin teknik dhe pjesët e ndërrimit sipas standartit teknik të përcaktuar nga prodhuesi.

III.2.2 Në shtojcën 8 të dokumentave të tenderit “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2/1.a autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

III.2.3 Në shtojcën 9 të dokumentave të tenderit, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

**Shtojca 9.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)  
**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	----- ---
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- -----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -----
E-mail:	----- -----

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

<i>Emri i nënkontraktorit të propozuar</i>	<i>NIPT – i</i>	<i>Përqindja e nënkontraktimit</i>	<i>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar</i>

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<i>Emri (at) e subjekteve</i>	<i>NIPT-i</i>	<i>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</i>	<i>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</i>

## **Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

### **A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

<b>Deklarata</b>
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</p> <p>_____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</p> <p>_____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p>

<i>etj.</i>				
<i>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<i>Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<i>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<i>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<i>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</i>				
<i>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<i>Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.</i>				
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>				
<hr/>				
<i>Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				

*Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

*Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.*

*Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

*Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

## **B: DEKLARATA**

### **Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

*Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:***

*Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.*

*Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër<sup>1</sup>.*

*Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:*

- a) çmimet;*
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;*

<sup>1</sup> Për qëllim të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

*Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.*

*Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.*

## **C: DEKLARATA**

### **Mbi Konfliktin e Interesit**

#### **Deklarata**

*Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:*

*Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.*

*Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:*

*- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.*

*Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.*

*Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku*

zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

#### **D: DEKLARATA**

##### ***Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës***

###### ***Deklarata***

*Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:*

- *Operatori ekonomik \_\_\_\_\_garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.*
- *Operatori ekonomik \_\_\_\_\_lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.*
- *Operatori ekonomik \_\_\_\_\_nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

#### **Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**

##### **A: DEKLARATË**

***Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:***

***Deklarata***

***Përgjigje***

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [ ] Jo [ ]

### **B: DEKLARATË**

#### **Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

<b>Deklarata</b>	<b>Përgjigje</b>
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [ ] Jo [ ] Nëse, po, numri i punonjësve: <hr/> Profili i punonjësve <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po [ ] Jo [ ] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: <hr/>
<b>Emri, Mbiemri</b> _____ <b>Firma</b> _____ <b>Vula</b> _____ <b>Data e dorëzimit të deklaratës</b> _____	

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për

*përrjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.*

- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*

*Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.*

- *Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.*
- *Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.*
- *Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara.*
- *Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.*

*Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.2.4. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji....”

III.2.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të

*lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:*

*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;*

*d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

*dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

*e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

*ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*

*f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*

*g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

*gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*

*h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);*

*i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*

*j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;*

*k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

*l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;*

*ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.*

*3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.2.6. Në interpretim të sa më sipër KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka detyrimin t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. Sikundër rezulton në faktet e parashtruara më sipër, në datë 16.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku konstatohet se operatori ekonomik “inAuto” SHPK rezulton të jetë kualifikuar nga KVO-ja. Ndërkohë në datë 11.03.2026 autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit, duke e skualifikuar operatorin ekonomik “inAuto” SHPK me arsyetimin si vijon: “- Sa më poshtë komisioni i vlerësimit të ofertave referuar pikës 1,a,b pikës 2,3,4 të nenit 80, si dhe nenit 92 të ligjit të Prokurimit publik, VKM 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik neni 75, pas rishqyrtimit dhe rivlerësimit të ofertave kostaton se operatori ekonomik inAuto nuk plotëson kriteret e vecanta të DST konkretisht në pikën 2.3.3 ku nga ana e Ak është kërkuar se; Operatori ekonomik duhet

*të dëshmojë se ka në pronësi ose kontratë bashkëpunimi me Servis të specializuar dhe të licensuar sipas rregulloreve të Republikës së Shqipërisë, për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruar, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale, akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB, etj dhe licensën përkatëse.) Nga ana e OE inAuto nuk është deklaruar në formularin e vetëdeklarimit shtojca 9, dhe nuk është ngarkuar në spe kontrata e bashkëpunimi me servis të specializuar, të licensuar sipas rregullores së Republikës së Shqipërisë për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruar kërkuar nga ak sipas pikës 2.3.3. Por në sistemin e prokurimit elektronik OE ka ngarkuar një deklarat të nënshkruar, ku shprehet së në momentin e dorëzimit të dokumentacionit fizik provues për procedurën e prokurimit do të paraqes dhe kontratën noteriale me subjektin përkatës të servisit, në përputhje të plotë me DST. Deklarata e sipërcituar është në kundërshtim të DST dhe kriterëve të veçanta, ligjit të Prokurimit Publik Nr.162 /2020 “Për prokurimin publik” pika 3 e nenit 92, pika b neni 98 si dhe Vendimin Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” të nenit 38”*

Nisur nga arsyeja e skualifikimit, si dhe referuar dokumenteve të tenderit pikës 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, shtojca nr. 8, parashikohet se: **“2.3.3 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose kontratë bashkëpunimi me Servis të specializuar dhe të licensuar sipas rregulloreve të Republikës së Shqipërisë, për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruar, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale, akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB, etj dhe licensën përkatëse.)**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162., datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40, pika 5 të VKM nr. 285., datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Kjo kërkesë lidhet me detyrimin e kontraktorit që gjatë gjithë shtrirjes të garancisë së mjetit të jetë në gjendje të sigurojë suportin teknik dhe pjesët e ndërrimit sipas standartit teknik të përcaktuar nga prodhuesi“, KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga KVO-ja pasi ka kryer rivlerësimin në datë 11.03.2026 nuk mund të jepen në këtë fazë procedurale. Referuar parashikimeve të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, kriteri i veçantë të kualifikimit i përcaktuar në shtojcën nr. 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.3 nuk përmbushet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, KVO nuk mund të shprehet në këtë fazë për përmbushjen të pikës 2.3.3 nisur nga fakti që ky kriter nuk përmbushet me formular përmbledhës të vetëdeklarimit. Akoma më tej KVO-ja me vlerësimin e kryer në datë 16.01.2026 pasi ka verifikuar dokumentacionin e dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik ankimues “inAuto” SHPK e ka kualifikuar këtë të fundit. Rivlerësimi i kryer nga KVO-ja në datë 11.03.2026 duke u rikthyer në fazën procedurale të vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar në SPE për operatorin ekonomik “inAuto” SHPK, për të cilin ky operator ekonomik ishte kualifikuar është në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Pra, veprimet e mësipërme të autoritetit kontraktor janë kryer, në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik dhe rregullat e prokurimit publik. Në këtë moment procedural nga ana e autoritetit kontraktor, duhej të kryhej verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “inAuto” SHPK, mbi kapacitetet që deri në fazën e vlerësimit konsideroheshin të përmbushura me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në zbatim të pikës 6 të nenit 26

të VKM nr. 285 datë 9.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson edhe njëherë faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, apo akoma më tej dhe afatet për verifikim të parashikuara shprehimisht në ligj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu, KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor.

III.2.7. Sa më sipër, KPP gjykon, se riskualifikimi në mënyrë të përsëritur i operatorit ekonomik ankimues është kryer në shkelje të parashikimeve ligjore. KPP i tërheq vëmendjen autoritetit kontraktor, për mosrespektim të dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me momentin procedural të verifikimit të dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike, dhe rivlerësimin e procedurës në shkelje të dispozitave ligjore. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit të cilat realizon, duhet të garantojë respektimin e parashikimeve ligjore në fuqi dhe parimeve të transparencës dhe efikasitetit parashikuar në nenin 2 të LPP-së. Në këtë kuptim, KPP e gjen riskualifikimin e ankimuesit të pabazuar në ligj dhe në kapërcim të afateve ligjore në fuqi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “inAuto” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “inAuto” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-73293-12-24-2025, me objekt: “BLERJE

AUTOMJETE”, me fond limit 8,300,000.00 (tetë milion e treqind mijë) Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.

2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Anadea” shpk për procedurën e prokurimit të mësipërme.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “nAuto” SHPK.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Anadea” SHPK
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

